



Project funded by the European Union



Proçesverbal i Takimit të 17-të të Grupit të Aktorëve
për
Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

**19 Prill 2017, Hotel “Life Galley”, Korçë,
Republika e Shqipërisë**

Pjesëmarrësit në takim:

Struktura e pjesëmarrësve në takimin e 17-të të Grupit të Aktorëve për rajonin ndërkufitar “Prespa” ka përfshirë 36 pjesëmarrës nga Rajoni i Prespës. Takimi u organizua dhe u lehtësua nga Staf i Njësise së Menaxhimit të Projektit me asistencën e Presidentes dhe Zëvendës-Presidentit të Grupit të Palëve të interesuara për rajonin ndërkufitar “Prespa”.

Lista e plotë e pjesëmarrësve dhe detaje për kontaktet e tyre mund të gjenden në:

ANNEX 1: Lista e pjesëmarrësve të takimit të 17-të të grupit të aktorëve për rajonin ndërkufitar “Prespa” 19.04.2017

ANNEX 2: PPP_Prespa arritjet dhe rezultatet

Programi i takimit:

Takimit i 17-të i Grupit të Aktorëve Për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

- | | |
|---------------|---|
| 10:00 – 10:30 | <i>Mbërritja e pjesëmarrësve dhe takimi i mirëseardhjes</i> |
| 10:30 – 10:45 | <i>Fjalimi i mirëseardhjes</i>
Përfaqësues nga Bashkia e Korçës
Përfaqësues nga Këshilli i Qarkut Korçë
Znj. Viola Bogdani, Presidente e Grupit të Aktorëve për Rajonin “Prespa”
Z. Naume Tashovski, Zëvendës President i Grupit të Aktorëve për Rajonin “Prespa”
Znj. Bojana Jovanovska, Menaxhere Rajonale për Rajonin Ndërkufitar “Prespa” |
| 10:45 – 11:15 | <i>Përmbledhje e aktiviteteve në kuadër të projektit të BE-së "Nxitja e bashkëpunimit rajonal dhe zhvillimit të balancuar territorial të vendeve të Ballkanit Perëndimor në procesin drejt integritimit në BE" në lidhje me zbatimin e ABDA në Rajonin Ndërkufitar “Prespa”</i>
Znj. Bojana Jovanovska, Menaxhere Rajonale për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”
Znj. Etleva Thimo, Koordinatore Rajonale për Rajonin Ndërkufitar “Prespa” |
| 11:15 – 11:30 | <i>Sesion informues rreth arritjeve të Thirrjes së Dytë të Skemës së Grantit ABD brenda projektit LEIWW</i>
Znj. Bojana Jovanovska, Menaxhere Rajonale për Rajonin Ndërkufitar “Prespa” |
| 11:30 – 12:00 | <i>Video Dokumentar “Prespa Liqeni i Mollëve”</i> |

- 12:00 – 12:10 *Konkluzionet dhe aktivitetet e ardhshme*
- 12:10 – 12:30 *Konferencë për mediat*
- 12:30 – 13:30 *Dreka*
- 13:30 *Kthimi*

Procesverbali i takimit

Takimi filloi me fjalën përshëndetëse të Presidentes dhe Zëvendës-Presidentit të grupit të palëve të interesuara për rajonin ndërkufitar të Prespës, Znj. Viola Bogdani dhe Z. Naumin Tashovski. Ata përshëndetën të pranishmit dhe shprehën kënaqësinë për praninë e aktorëve në takimin e 17-të të grupit palëve të interesuara. Përveç kësaj, ata theksuan punën e bërë nga grupi i aktorëve dhe rëndësinë e këtyre takimeve gjatë gjithë fazës së implementimit të qasjes ABDA dhe konfirmuan intensifikimin e bashkëpunimit mes aktorëve nëpërmjet organizimit të aktiviteteve të ndryshme dhe ngjarjeve të përbashkëta rajonale në rajonin e Prespës.

Në emër të Ambasadës Maqedonase në Shqipëri foli Znj. Anita Nichoska, këshilltare në Ambasadën Maqedonase në Tiranë e cila përshëndeti pjesëmarrësit dhe shprehu kënaqësinë për pjesëmarrjen në takimin e grupit të aktorëve për rajonin ndërkufitar Prespa. Ajo shprehu mbështetjen maksimale të Ambasadës Maqedonase në Tiranë për një bashkëpunim edhe në të ardhmen me grupin e antarëve Prespa në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta ndërkufitare.

Më pas, në emër të Bashkisë Korçë, Znj. Aida Shkodrani, përshëndeti pjesëmarrësit dhe shprehu kënaqësinë për përfshirjen e Bashkisë Korçë në aktivitete të tilla të rëndësishme në rajonin ndërkufitar. Ajo shprehu mirënjohjen për bashkëpunimin e frutshëm në aktivitetet rajonale të organizuara deri tani në Bashkinë Korçë nën programin Njerëzit për Njerëzit. Në përfundim, ajo shprehu optimizmin dhe mbështetjen maksimale për një bashkëpunim edhe në të ardhmen.

Në vazhdim, Znj. Bojana Jovanovska Menaxhere Rajonale për rajonin ndërkufitar "Prespa", falenderoi të gjithë pjesëmarrësit për prezencën dhe uroi një bashkëpunim të frutshëm në vazhdim. Më pas ajo prezantoi programin e takimit duke u ndalur në çështjet për tu trajtuar.

Sesioni 1

Përmbledhje e aktiviteteve në kuadër të projektit të BE-së "Nxitja e bashkëpunimit rajonal dhe zhvillimit të balancuar territorial të vendeve të Ballkanit Perëndimor në procesin drejt integrimit në BE" në lidhje me zbatimin e ABDA në Rajonin Ndërkufitar "Prespa"

Seanca filloi me prezantimin e Znj. Etleva Thimo, Koordinatore Rajonale për Rajonin Ndërkufitar "Prespa", e cili bëri një pasqyrim të përgjithshëm të aktiviteteve të kryera dhe arritjeve në kuadër të projektit të BE-së "Nxitja e bashkëpunimit rajonal dhe zhvillimit të balancuar territorial të vendeve të Ballkanit Perëndimor në procesin drejt integrimit në BE" për rajonin ndërkufitar "Prespa". Prezantimi u fokusuar në arritjet dhe rezultatet e përgjithshme gjatë periudhës Qershor 2015 – Prill 2017. Kështu, duke theksuar objektivat e projektit prezantimi u përqëndrua në mënyrën e zbatimit të qasjes ABDA në rajonin e Prespës. Zbatimi i projektit ka përfshirë zhvillimin e një sërë aktiviteteve, si aktivitetet rajonale Njerëzit për Njerëzit, zhvillimin e aplikimeve për projekte, takime të rregullta mes grupit palëve të interesit si dhe krijimin e dokumenteve të politikave në përputhje me acquis-ën e Bashkimit Evropian. Duke përfunduar prezantimin u theksua edhe njëherë rëndësia e zhvillimit të integruar ekonomik në rajonin ndërkufitar të Prespës, duke organizuar shkëmbim informacioni dhe veprime të përbashkëta mes aktorëve në rajonin ndërkufitar "Prespa".

Gjithashtu, gjatë diskutimeve u theksua se në vazhdimësi puna e grupit të aktorëve duhet të fokusohet në ngritjen e grupeve të ndyshme të punës për sektorë të rëndësishëm. Kështu, u sugjerua se konkretisht këto grupe duhet të përqëndrohen në prioritetet kryesore për zhvillimin e rajonit ndërkufitar, të sektorit të bujqësisë dhe turizmit. Gjithashtu, këto grupe pune mund të fokusojnë punën e tyre edhe në detaje të çështjeve, problematikave dhe sfidave të sektorëve respektivë. Ngritja e këtyre grupeve të punës do të ndikojë në rritjen e gjërë të bashkëpunimit ndërkufitar duke përfshirë aktorë të rinj në grup si edhe do të krijojë mundësi për të përmirësuar edhe më tej zhvillimin e integruar ekonomik të rajonit.

Sesioni 2

Sesion informues rreth arritjeve të Thirrjes së Dytë të Skemës së Grantit ABD brenda projektit LEIWW

Sesioni filloi me prezantimin e Znj. Bojana Jovanovska Menaxhere Rajonale për rajonin ndërkufitar "Prespa", e cila bëri një prezantim të zbatimit të skemës së grantit ABD brenda projektit LEIWW. Gjatë prezantimit ajo dha një shpjegim të përgjithshëm të të gjithë procesit të zbatimit dhe vlerësimit të aplikimeve për skemën e grantit. Në vazhdim, informacion i përgjithshëm u dha në lidhje me rezultatet finale të thirrjes së dytë për rajonin ndërkufitar Prespa. Kështu, në total ishin nëntëmbëdhjetë (19) projekt aplikime të dorëzuara, prej të cilave (10) dhjetë projekt aplikime rezultuan fituese gjatë procesit të vlerësimit dhe gjatë muajit Mars 2017, zyrtarisht u nënshkruan kontratat me përfituesit e granteve. Ndërkohë, në pamundësi fondesh, një (1) projekt aplikim i cili rezultoi fitues gjatë procesit të vlerësimit duke plotësuar pikët e nevojshme u vendos në listën e pritjes për mbështetje të mundshme në të ardhmen. Gjithashtu, u theksua se projekt aplikimet e dorëzuara për rajonin e Prespës u fokusuan kryesisht në sektorin e bujqësisë dhe atë të turizimit.

Gjatë diskutimit të hapur u theksua se zbatimi i skemës së grantit ka qënë një mundësi shumë e mirë për përmirësimin e kushteve të biznesit dhe zhvillimit të integruar ekonomik të rajonit Prespa. Gjithashtu u theksua se gjatë kësaj faze të zbatimit të projektit janë arritur një sërë rezultatesh pozitive, përfshirë edhe pjesëmarrjen më të gjërë të aktorëve të rinj nga sektorë të tjerë të rëndësishëm në grup duke intensifikuar bashkëpunimin mes aktorëve dhe qëndrueshmërinë e grupit. Ndërkohë u sugjerua se në vazhdimësi duhet të punohet më tej për përfshirjen edhe më të madhe të sektorit të biznesit në grupin e palëve të interesuara për rajonin e Prespës.

Në përfundim të sesionit u paraqit edhe një video dokumentar i realizuar për liqenin e Prespës, "Prespa Liqeni i Mollëve", nën mesazhin se natyra dhe fqinjësitë mund të zhvillohen së bashku.

Sesioni 3

Konkluzione dhe mbyllja e takimit

Në sesioni e fundit u dhanë konkluzionet si mëposhtë:

- Gjatë periudhës Qershor 2015 – Prill 2017 të zbatimit të projektit të BE-së "Nxitja e bashkëpunimit rajonal dhe zhvillimit të balancuar territorial të vendeve të Ballkanit Perëndimor në procesin drejt integritimit në BE" për rajonin ndërkufitar "Prespa", zbatimi i projektit përfshiu realizimin e një sërë aktivitetesh si aktivitetet rajonale Njerëzit për Njerëzit, zhvillimin e aplikimeve për projekte, takime të rregullta mes grupit palëve të interesit si dhe krijimin e dokumenteve të politikave në përputhje me acquis-ën e Bashkimit Evropian;
- Gjithashtu gjatë kësaj faze të zbatimit të projektit janë arritur një sërë rezultatesh pozitive, përfshirë edhe pjesëmarrjen më të gjërë të aktorëve të rinj nga sektorë të tjerë të rëndësishëm në grup duke intensifikuar bashkëpunimin mes aktorëve dhe qëndrueshmërinë e grupit. Ndërkohë u sugjerua se në vazhdimësi duhet të punohet më tej për përfshirjen edhe më të madhe të sektorit të biznesit në grupin e palëve të interesuara për rajonin e Prespës;
- Zbatimi i skemës së granetve ABD nën projektin LEIWW ka qënë një mundësi shumë e mirë për përmirësimin e kushteve të biznesit dhe zhvillimit të integruar ekonomik të rajonit Prespa;
- Projekt aplikimet e dorëzuara për rajonin e Prespës u fokusuan kryesisht në sektorin e bujqësisë dhe atë të turizmit. Në total ishin nëntëmbëdhjetë (19) projekt aplikime të dorëzuara, prej të cilave (10) dhjetë projekt aplikime rezultuan fituese gjatë procesit të vlerësimit dhe gjatë muajit Mars 2017, zyrtarisht u nënshkruan kontratat me përfituesit e granteve. Ndërkohë, në pamundësi fondesh, një (1) projekt aplikim, i cili rezultoi fitues gjatë procesit të vlerësimit duke plotësuar pikët e nevojshme u vendos në listën e pritjes për mbështetje të mundshme në të ardhmen;
- Në të ardhmen u sugjerua që puna e grupit duhet të fokusohet në ngritjen e grupeve të ndryshëm punës për sektorë të rëndësishëm zhvillimore të rajonit të Prespës. Gjithashtu, u sugjerua që këto grupe duhet të përqëndrohen në prioritetet kryesore për zhvillimin e rajonit ndërkufitar, të sektorit të bujqësisë dhe turizmit. Ndërkohë këto grupe pune do të fokusojnë punën në detaje të çështjeve, problematikave dhe sfidave të sektorëve respektive;
- Ngritja e grupeve të punës do të ndikojë në rritjen e gjërë të bashkëpunimit ndërkufitar duke përfshirë aktorë të rinj në grupin e palëve të interesit Prespa

si edhe do të krijojë mundësi për të përmirësuar edhe me tej zhvillimin e integruar ekonomik të rajonit;

- Njësia për menaxhimin e projektit “Prespa” dhe SWG do të vazhdojnë të shërbejnë si një pikë informative ku antarët e grupit të marrin informacion e nevojshëm për thirrje të reja për projekt propozime. Ata do të vazhdojnë të mbështesin përgatitjen e aplikimeve për projekt propozime të ndryshme si edhe do të lehtësojnë partneritetet për programe aktive IPA, CBC në rajon dhe thirrje të tjera të aktive për rajonin;
- Konferenca për shtyp u realizua nën praninë e mediave lokale dhe kombëtare me qëllim promovimin dhe informimin rreth takimit të Grupit të Aktorëve për Rajonin Ndërkufitar “Prespa” dhe mbylljen e projektit të financuar nga BE: “Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe zhvillimi i balancuar territorial i vendeve të Ballkanit Perëndimor në procesin e integritimit në BE” .

Përgatiti:

Etleva Thimo, Koordinatore Rajonale për Rajonin Ndërkufitar të Prespës

Bojana Jovanovska, Menaxhere Rajonale për Rajonin Ndërkufitar të Prespës